



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.149

5 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 157 datë 15.10.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar	6647
Ligj nr.10 158 datë 15.10.2009	Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore	6650
Ligj nr.10 159 datë 15.10.2009	Për shfuqizimin e ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave, që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave”	6670
Ligj nr.10 160 datë 15.10.2009	Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë	6671
Ligj nr.10 161 datë 15.10.2009	Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2008	6676
Vendim i KM nr.1020, datë 14.10.2009	Për krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të asistencës, akredituar nga Bashkimi European	6677

LIGJ
Nr.10 157, datë 15.10.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9663, DATË 18.12.2006 “PËR KONCESIONET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pika 14 ndryshohet si më poshtë:

“14. Agjencia e Koncesioneve” është institucion publik, e ngritur dhe që funksionon në përputhje me këtë ligj.”.

Neni 2

Neni 6 shfuqizohet.

Neni 3

Në kreun III “Procedurat e rishikimit administrativ”, para nenit 25 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

Neni 24/1

Agjencia e Koncesioneve

1. Agjencia e Koncesioneve është person juridik publik buxhetor, në varësi të Kryeministrit, që funksionon në bazë të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Koncesioneve.

3. Agjencia e Koncesioneve, në ushtrim të funksioneve të saj, ka këto kompetenca:

a) mbikëqyr zbatimin e procedurave koncesionare dhe bën shqyrtimin administrativ të ankesave ndaj këtyre procedurave;

b) verifikon zbatimin nga ana e autoritetit kontraktues të procedurave të koncesionit, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera të dala në zbatim të tij, duke u kërkuar autoriteteve koncesionare të gjithë informacionin e nevojshëm;

c) bën shqyrtimin administrativ të ankesave të ofertuesve për procedurat koncesionit;

ç) propozon masa disiplinore dhe vendos gjopa për personat e ngarkuar nga autoriteti kontraktues me hartimin e dokumenteve, zbatimin e procedurës parakualifikuese, vlerësimin e kriterëve, përzgjedhjen e ofertave dhe negocimin e kontratës, sipas rregullave të koncesionit, në masën e përcaktuar në legjislacionin e koncesioneve, në rastet kur vëren shkelje të procedurave të këtij ligji;

d) vendos dhe shpall përjashtimin nga procedurat koncesionare të ofertuesve, të cilët, gjatë një procedure koncesionare, kanë depozituar dokumente false, ose kanë deklaruar informacion të rremë, si dhe, kur është rasti, bën kallëzim penal;

dh) mbyll hetimin administrativ dhe, kur pranon ankimin, për shkeljet e konstatuara në procedurën e koncesioneve, propozon masat përkatëse për rregullimin ose anulimin e tyre;

e) mban dhe administron regjistrin e koncesionit, si dhe dokumentacionin origjinal që dërgohet nga autoritetet kontraktuese brenda 3 muajve nga data e miratimit të kontratës së koncesionit;

ë) u kërkon autoriteteve kontraktuese raportime periodike 1 herë në 6 muaj për gjendjen e koncesioneve dhe, bazuar në çështjet e raportuara dhe të shqyrtuara, i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandime të përgjithshme për gjendjen dhe për kuadrin ligjor të koncesioneve.”.

Neni 4

Në nenin 25 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Agjencia e koncesioneve, gjatë procedurave të hetimit administrativ, ka të gjitha kompetencat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.”.

2. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

“7/1. Çdo ankesë në Agjencinë e Koncesioneve, që merret në shqyrtim nga kjo e fundit, duhet të shoqërohet me pagesën paraprake prej 10% të vlerës së garancisë së ofertës. Moskryerja e pagesës paraprake përbën shkak për mosfillimin e shqyrtimit të ankesës. Kjo pagesë i kthehet subjektit kur, në fund të procesit të ankimit, ankesa e tij pranohet ose kalon në favor të Buxhetit të Shtetit, kur ankesa nuk pranohet. Forma dhe mënyra e kryerjes së kësaj pagese përcaktohen në rregullat e koncesionit.”

3. Në pikën 8 afati “20 ditë kalendarike” zëvendësohet me afatin “30 ditë kalendarike”.

Neni 5

Pas nenit 25 shtohen nenet 25/1, 25/2 dhe 25/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Procedura e hetimit administrativ

1. Agjencia e Koncesioneve fillon procedurën e hetimit administrativ mbi bazën e ankimit të një apo më shumë palëve pjesëmarrëse në një procedurë koncesioni.

2. Agjencia e Koncesioneve, për të realizuar funksionet e saj, ka të drejtë të ketë akses në çdo institucion të administratës publike, të cilat, sipas këtij ligji, njihen si autoritete kontraktuese.

3. Agjencia e Koncesioneve ka të drejtë të caktojë një afat për informacionin që duhet të japë autoriteti kontraktues, në bazë të kërkesës së saj, si dhe për dorëzimin e dokumenteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon procedurat administrative.

Neni 25/2

Përfundimi i hetimit administrativ

1. Agjencia e Koncesioneve, pas përfundimit të hetimit administrativ, merr këto vendime:

a) pranon ankimin e ankuesit, duke arsyetuar e argumentuar shkeljet e konstatuara në zbatimin e ligjit e të procedurave për koncesionet, duke treguar masat përkatëse për anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë në veprimet e autoritetit kontraktues;

b) rrëzon ankimin e palës, duke konstatuar zbatimin e procedurave dhe ligjshmërisë për veprimet apo mosveprimet e paraqitura si shkelje nga ankimesi, duke i sqaruar atij me shkrim arsyet e rrëzimit të ankimit;

c) për shkeljet e konstatuara në procedurën e koncesioneve e të ligjshmërisë në zbatimin e ligjit, i jep autoritetit kontraktor një afat, brenda të cilit ky i fundit është i detyruar t'i ndreqë ato, ose të ndalojë efektin apo pasojat negative të këtyre shkeljeve.

2. Vendimi i dhënë sipas pikës 1 të këtij neni është i ekzekutueshëm. Ndaj tij palët mund të bëjnë ankim në gjykatë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 25/3

Detyrimi për bashkëpunim

Refuzimi i nëpunësit civil, i funksionarit ose autoritetit kontraktues për të dhënë informacion apo për të paraqitur dokumentacionin që ka lidhje me procedurën nën hetim administrativ, përbën shkak që agjencia të kërkojë nga autoriteti kompetent dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.”.

Neni 6

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Kundërvajtjet administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji nga personat përgjegjës, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50-100 mijë lekë. Gjoha vendoset nga titullari i Agjencisë së Koncesioneve. Kundër dënimit me gjobë mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve në gjykatën kompetente.

2. Titullari i agjencisë mund t’i propozojë drejtuesit të autoritetit kontraktor, nëse e gjykon të nevojshme, edhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës që shkelin dispozitat e këtij ligji.”.

Neni 7

Kudo në ligj, emërtimi “Agjencia e Prokurimit Publik” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Koncesioneve”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6305, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 158, datë 15.10.2009

PËR OBLIGACIONET E SHOQËRIVE AKSIONARE DHE TË QEVERISË VENDORE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
RREGULLA ME ZBATIM TË PËRGJITHSHËM

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për obligacionet:
 - a) e shoqërisë aksionare, me zyrë qendrore në Republikën e Shqipërisë;
 - b) e qeverisë vendore.
2. Ky ligj nuk zbatohet në rastet e obligacioneve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë apo të Bankës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “Agjent i zotëruesit të obligacioneve” është subjekti që përfaqëson grupin e zotëruesve të obligacioneve përkundrejt emetuesit dhe palëve të treta.
 - b) “AMF” ose “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, krijuar në përputhje me ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.
 - c) “Certifikatë obligacioni” është certifikata e një obligacioni të vetëm.
 - ç) “Certifikatë shumëfishe obligacioni” është certifikata e obligacionit, e cila përmban më shumë se një obligacion.
 - d) “Program huaje” është programi, që përmban kushtet dhe afatet e marrjes hua të fondeve, nëpërmjet emetimit të obligacioneve.
 - dh) “Kujdestar” është subjekti, sipas përcaktimit të ligjit për titujt, i cili ka hapur një llogari titujsh pranë Regjistrarit dhe administron titujt, sipas porosisë së zotëruesit të obligacioneve.
 - e) “Obligacion” është një titull afatgjatë borxhi, që detyron emetuesin t’i paguajë zotëruesit të obligacionit vlerën nominale dhe interesin, me një apo disa këste, në një datë të caktuar.
 - ë) “Obligacion i konvertueshëm” është obligacioni, që konvertohet në aksion të shoqërisë, apo obligacioni, që i jep zotëruesit të tij të drejtën ekskluzive për blerjen e aksioneve.
 - f) “Obligacion me pjesëmarrje” është obligacioni, që i jep zotëruesit të drejta shtesë për të përfituar dividendë.
 - g) “Obligacion i këmbyeshëm” është obligacioni, që i jep zotëruesit të drejtën shtesë t’i kërkojë emetuesit, nëpërmjet një deklarimi, që përmbushja e plotë apo e pjesshme e detyrimeve të pagimit të principalit të kryhet nëpërmjet transferimit të titujve, të parashikuara në kushtet e programit të huasë së obligacioneve.

gj) “Obligacioni i dematerializuar” është regjistrimi elektronik në llogarinë, në sistemin kompjuterik të Regjistrarit.

h) “Obligacioni afatgjatë” është obligacioni me afat maturimi më të gjatë se dymbëdhjetë muaj.

i) “Regjistrari” është subjekti i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, objekti i veprimtarisë së të cilit përfshin organizimin dhe administrimin e të dhënave për titujt, sipas përcaktimit të ligjit për titujt.

j) “Zotërues i obligacionit”, në rastin e obligacioneve të dematerializuara, është subjekti, në emër të të cilit hapet llogaria pranë Regjistrarit dhe regjistrohet obligacioni i dematerializuar.

Neni 3

Llojet dhe seritë e obligacioneve

1. Obligacionet emetohen në formë të dematerializuar në rastin kur ofrohen nëpërmjet ofertës publike. Obligacionet mund të emetohen në formë të materializuar, në letër, në rastin kur ofrohen nëpërmjet ofertës private.

2. Përveç llojeve të obligacioneve të përkufizuara në ligjin për titujt, Autoriteti ka të drejtë të përcaktojë, me anë të një rregulloreje, lloje të tjera obligacioni, të cilat emetohen dhe tregtohen në Republikën e Shqipërisë.

3. Obligacionet emetohen në disa seri dhe vlera nominale e obligacionit mund të jetë e ndryshme në çdo seri.

4. Lejohet lëshimi i certifikatës së obligacionit apo i certifikatës shumëfishe të obligacionit.

Neni 4

Obligacionet në letër

1. Certifikata e obligacionit në letër përfshin elementet e mëposhtme:

a) emrin e emetuesit, adresën e zyrës qendrore, numrin e regjistrimit në QKR;

b) llojin, garanci nëse ka, vendin dhe datën e emetimit të obligacionit dhe të regjistrimit të tij në QKR;

c) vlerën nominale të çdo obligacioni;

ç) vlerën totale nominale të obligacionit;

d) emrin e zotëruesit të obligacionit;

dh) vendin, kohën dhe mënyrën e ripagimit të obligacionit;

e) nënshkrimin e përfaqësuesve ligjorë të emetuesit;

ë) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e të drejtave të zotëruesit të obligacioneve dhe, në veçanti, të garancive për obligacionet, të së drejtës së konvertimit apo të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e emetuesit;

f) numrin e serive të obligacioneve;

g) nivelin e interesit, nëse obligacioni mbart interes, si dhe mënyrën e kohën e pagesës së tij;

gj) çdo të drejtë të emetuesit për përfundimin para afatit (ripagimit të borxhit) të obligacionit;

h) vlerën e kapitalit themeltar të emetuesit dhe vlerën, që rezulton në datën e emetimit, në rastin kur emetuesi është shoqëri aksionare.

2. Për transferimin e obligacioneve në letër nga një zotërues në një tjetër zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe të ligjit për titujt.

3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton një limit për shumën e përgjithshme të obligacioneve, që mund të emetojë shoqëria aksionare.

Neni 5
Obligacionet e dematerializuara

1. Obligacionet e dematerializuara regjistrohen, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin për titujt, pranë Regjistrarit të zgjedhur nga emetuesi. Llogaritë e obligacioneve të dematerializuara mbahen në përputhje me ligjin për titujt.

2. Kujdestari përgjigjet për regjistrimet hyrëse, regjistrimet e dhënies, të veprimeve dhe pagesave të obligacioneve, për llogari të emetuesit.

3. Asetet, që përdoren për përmbushjen e detyrimeve, të cilat rrjedhin nga obligacioni, transferohen nga kujdestari te zotëruesit e obligacioneve, menjëherë pas marrjes së këtyre aseteve nga emetuesi.

4. Regjistrari lëshon për zotëruesit e obligacioneve, të cilët kanë një llogari me të, certifikata dhe vërtetime për çdo ndryshim në llogari.

Neni 6
Tregtimi i obligacioneve të dematerializuara

Tregtimi i obligacioneve të dematerializuara kryhet në përputhje me ligjin për titujt.

Neni 7
Kalimi i të drejtave të obligacioneve të dematerializuara

1. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në nenin 8 të këtij ligji, ndryshimi apo regjistrimi në llogari i titullit është i pavlefshëm, nëse ndërmjetësi përkatës nuk është autorizuar, nga kujdestari apo me vendim gjykatë, të kryejë ndryshimin apo regjistrimin e mësipërm.

2. Të gjitha pagesat nga emetuesi te zotëruesi i obligacionit, që rrjedhin nga obligacioni i dematerializuar, duhet të kryhen nga kujdestari, nëpërmjet Regjistrarit.

Neni 8
Blerja e obligacioneve të dematerializuara në mirëbesim

1. Nëse obligacionet e dematerializuara kreditohen në llogari në kohën kur një palë e tretë ka të drejta mbi këta tituj dhe zotëruesi i këtij titulli ka dijeni apo, nga pakujdesia, nuk merr parasysh të drejtat e palës së tretë dhe kreditimi i mësipërm mund të cenojë të drejtat e palës së tretë, për këtë interesim/pretendim:

a) kujdestari nuk cenohet nga të drejtat e palës së tretë;
b) kujdestari nuk mban përgjegjësi para palës së tretë;
c) kreditimi është i vlefshëm dhe nuk anulohet me arsyetimin se të drejtat e palës së tretë shkaktojnë pavlefshmërinë e çdo debitimi apo kreditimi të mëparshëm të një llogarie tjetër titujsh.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për pengun mbi obligacionet e dematerializuara.

Neni 9
Çështje të veçanta

1. Obligacionet e prurësit, që paguhen me dorëzim, emetohen për një afat të përcaktuar.

2. Me përjashtim të dispozitave të këtij kreu mbi obligacionet e dematerializuara, emetuesi detyrohet t'u lëshojë dhe dorëzojë certifikatë obligacioni zotëruesve të obligacioneve. Në rast se janë lëshuar certifikata shumëfishe të obligacioneve, me kërkesë të zotëruesit të tyre, emetuesi detyrohet të zëvendësojë certifikatat e mëparshme me certifikata të reja, që përmbajnë një numër më të vogël obligacionesh.

3. Emetuesi ka të drejtë të emetojë certifikata të përkohshme, deri në lëshimin e certifikatave përfundimtare të obligacioneve.

KREU II KUJDESTARI

Neni 10 Veprimtaria e kujdestarit

Kujdestari, në përputhje me ligjin për titujt, përgjigjet për kleringun dhe shlyerjen e transaksioneve për titujt, që mbahen në llogari.

Neni 11 Licencimi i kujdestarit

1. Ushtrimi i veprimtarisë së kujdestarit licencohet nga autoriteti, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
2. AMF-ja përcakton, me rregullore, afatet, kushtet dhe procedurën për licencimin e kujdestarit.

Neni 12 Informimi nga kujdestari

1. Kujdestari informon me shkrim, përpara kryerjes së transaksionit, zotëruesit e obligacioneve, që tregtojnë obligacione të dematerializuara në tregjet mbi banak, për çmimin e blerjes dhe të shitjes së obligacioneve. Në mënyrë të veçantë, njoftimi përcakton çdo komision, tarifë, shpenzim apo diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, si dhe diapazonin e luhatjes së çmimit të këtyre obligacioneve në ditën paraardhëse të tregtimit.
2. Autoriteti mund të përcaktojë, me rregullore, detyrime të tjera specifike për kujdestarët, në lidhje me informacionin që i jepet zotëruesve të obligacioneve, për obligacionet e tregtuara në tregjet mbi banak.

Neni 13 Mbikëqyrja, sanksionet, konfidencialiteti

1. Autoriteti mbikëqyr veprimtarinë e kujdestarit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
2. AMF-ja e tërheq licencën e kujdestarit nëse ky i fundit nuk i përmbush më kërkesat e përcaktuara nga ky ligj.
3. Në rast se kujdestari shkel detyrimet e parashikuara në ligj, Autoriteti vendos gjobë, në përputhje me ligjin për titujt. AMF-ja mund të miratojë, me rregullore, masa ndëshkuese shtesë në rastin e shkeljes së detyrimeve nga ana e kujdestarit.
4. Kujdestari është i liruar nga detyrimi ndaj klientit për ruajtjen e konfidencialitetit, në lidhje me veprimet në llogari, kreditimin dhe debitimin e llogarisë, me kleringun dhe shlyerjen e transaksioneve me titujt e regjistruar në llogari apo në lidhje me çdo çështje tjetër të rëndësishme për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit, kur informacioni konfidencial kërkohet nga ky i fundit.

KREU III PROGRAMI I HUASË ME OBLIGACIONE

Neni 14 Përmbajtja e programit

1. Çdo obligacion shoqërohet nga një program huaje.
2. Programi i huasë përmban me hollësi kushtet dhe afatet e obligacionit. Programi është i detyrueshëm për t'u zbatuar për emetuesin, zotëruesin e obligacioneve dhe pasardhësit e tyre, si dhe nga çdo palë e tretë përfituese.

3. Programi i huasë miratohet nga organi vendimmarrës i emetuesit, i cili është përgjegjës për emetimin e obligacionit.

4. Programi i huasë hartohet me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme dhe përfshin informacionin e përmendur në nenin 17 të ligjit për titujt dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, që mund të përdoret nga investitorët, për të bërë vlerësime objektive për pritshmërinë dhe rreziqet e investimeve.

Neni 15

Ndryshimi i programit të huasë

1. Çdo ndryshim në programin e huasë miratohet, paraprakisht, nga grupi i zotëruesve të obligacioneve, siç përcaktohet në nenet 16 e 22 të këtij ligji.

2. Grupi i zotëruesve të obligacioneve, me vendim të posaçëm, autorizon agjentin e zotëruesve të obligacioneve për të negociuar dhe rënë dakord me emetuesin, për ndryshimin e programit të huasë. Vendimi për autorizimin merret në përputhje me nenin 22 të këtij ligji.

3. Vendimi i grupit të zotëruesve të obligacioneve përcakton çështjet, për të cilat agjenti i zotëruesve të obligacioneve mund të bëjë negociim dhe marrëveshje, duke përfshirë, gjithashtu, udhëzime të veçanta për negociatat. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve duhet ta zbatojë këtë vendim dhe mban përgjegjësi për çdo dëm, të shkaktuar nga shkelja e porosive të zotëruesve të obligacioneve.

4. Vendimi për autorizim i grupit të zotëruesve të obligacioneve i njoftohet menjëherë emetuesit nga agjenti i zotëruesve të obligacionit.

KREU IV

GRUPI I ZOTËRUESVE TË OBLIGACIONEVE

Neni 16

Organizimi i zotëruesve të obligacioneve në grup

1. Organizimi i zotëruesve të obligacioneve në grup është i detyrueshëm në çdo rast të emetimit të obligacioneve, ku marrin pjesë, të paktën, dy zotërues obligacionesh. Grupi i zotëruesve të obligacioneve nuk ka personalitet juridik. Në rastin kur vetëm një zotërues obligacioni është pjesë e obligacionit, ai ushtron, në mënyrë të barabartë, të drejtat e të gjithë grupit.

2. Data dhe vendi për mbledhjen e parë përcaktohen nga emetuesi menjëherë pas emetimit të obligacioneve dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të procesit të emetimit të tyre. Për emërimin e agjentit të zotëruesit të obligacioneve në mbledhjen e parë të zotëruesve të obligacioneve zbatohet neni 26 i këtij ligji. Në rast të pamundësisë apo të refuzimit, pa shkak ligjor, të emetuesit, për të organizuar mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve, çdo zotërues obligacionesh, me nismën e vet, mund të kërkojë, nëpërmjet gjykatës, zhvillimin e kësaj mbledhjeje.

3. Në rastet e emetimit të obligacioneve me seri të ndryshme, zotëruesit e obligacioneve të një serie formojnë grup të veçantë. Grupet e veçanta të zotëruesve të obligacioneve kanë të drejtë të grupohen në një grup të vetëm, kur kushtet dhe afatet e serive të obligacioneve janë të njëjta.

Neni 17

Vendimet e grupit të zotëruesve të obligacioneve

1. Grupi i zotëruesve të obligacioneve merr vendime për çdo çështje të përcaktuar nga ky ligj dhe programi i huasë. Grupi i zotëruesve të obligacioneve nuk mund të marrë vendime, që trajtojnë, në mënyrë të pabarabartë, zotëruesit e obligacioneve.

2. Grupi i zotëruesve të obligacioneve nuk merr vendime, të cilat krijojnë detyrime shtesë për zotëruesit e obligacioneve, për sa kohë që këto detyrime nuk bëhen në interesin e tyre të përbashkët.

3. Në rastin e emetimeve, që nuk i përkasin grupit të zotëruesve të obligacioneve, sipas kushteve dhe afateve të obligacionit, të përfshira në programin e huasë apo të këtij ligji e që kanë efekt tek të drejtat e zotëruesve të obligacioneve, për kushtet dhe afatet e programit të huasë, të drejtat përkatëse mund të ushtrohen individualisht nga secili zotërues.

4. Vendimi i grupit të zotëruesve të obligacioneve duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe afatet e programit të huasë, sipas kreut III të këtij ligji, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 18

Përgjegjësitë e veçanta të grupit të zotëruesve të obligacioneve

Vetëm grupi i zotëruesve të obligacioneve ka të drejtën për të vendosur për:

a) heqjen dorë të çdo zotëruesi të obligacioneve nga e drejta për përdorimin e mjeteve apo të instrumenteve ligjore;

b) paraqitjen e kërkesës për deklarimin e falimentimit të emetuesit;

c) arritjen e marrëveshjeve për pretendimet e zotëruesve të obligacioneve ndaj emetuesit, që rrjedhin nga programi i huasë dhe ligji;

ç) çlirimin e kolateraleve apo të garancive, të dhëna për të siguruar obligacionin;

d) pëlqimin në lidhje me propozimin e emetuesit për të emetuar obligacione të tjera, pretendimet e të cilave përmbushen në mënyrë të privilegjuar ose kushtet e të cilave u japin zotëruesve të rinj të obligacioneve të drejta të tilla, që cenojnë statusin e zotëruesve ekzistues;

dh) ndryshimin e vlerës nominale të obligacionit, interesit apo të mënyrës së llogaritjes së këtij interesi;

e) zgjatjen e afatit të maturimit të obligacionit apo të afatit të pagimit të interesit;

ë) shkarkimin dhe zëvendësimin e agjentit të zotëruesve të obligacioneve;

f) përfundimin e huasë së marrë, duke emetuar obligacione;

g) autorizimin e agjentit të zotëruesve të obligacionit për negocimin e kushteve dhe të afateve të obligacionit, sipas programit të huasë, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

Neni 19

Mbledhja e grupit të zotëruesve të obligacioneve

1. Mbledhja e grupit të zotëruesve të obligacioneve thirret nga agjenti i zotëruesve të obligacioneve ose, në mungesë të agjentit të tyre, nga vetë emetuesi, apo në rast likuidimi a falimentimi të emetuesit, nga likuiduesi apo administratori i falimentimit të emetuesit. Rendi i mbledhjes përgatitet nga njëri prej personave të mësipërm, që thërret mbledhjen.

2. Personi, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, është i detyruar të thërrasë, gjithashtu, mbledhjen e grupit të zotëruesve të obligacioneve me kërkesën e zotëruesve të obligacioneve, të cilët përfaqësojnë të paktën 1/20 e vlerës totale të obligacionit (apo serive përkatëse). Kërkesa e zotëruesve të obligacioneve përmban, gjithashtu, rendin e mbledhjes. Mbledhja thirret jo më parë se 10 ditë pune dhe jo më vonë se 20 ditë pune nga data e marrjes së kërkesës nga zotëruesit e obligacioneve. Në rast se mbledhja nuk realizohet brenda afatit të përcaktuar, zotëruesit e obligacioneve kërkojnë thirrjen e mbledhjes nëpërmjet gjykatës. Gjykata përcakton vendin dhe kohën e mbledhjes. Shpenzimet mbulohen nga emetuesi.

3. Kërkesa për thirrjen e mbledhjes, sipas pikës 2 të këtij neni, përpara se të kenë kaluar 6 muaj nga mbledhja e fundit, ku u vendos për të njëjtat çështje, për të cilat kërkohet të thirret edhe takimi i ri, vlerësohet si kërkesë abuzive dhe refuzohet, në rast se nuk ka një shkak dhe ndonjë arsye për justifikimin e mbledhjes së re.

4. Në rast se ky ligj apo programi i huasë nuk përmbajnë dispozita për mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve, atëherë zbatohen, respektivisht, dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, që rregullojnë thirrjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të një shoqërie aksionare.

Neni 20

Ftesa drejtuar zotëruesve të obligacioneve

1. Në rastet e emetimit të obligacioneve të regjistruara, të cilat shpërndahen nëpërmjet ofertës private, dhe për sa kohë këto obligacione nuk janë listuar, në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, mund të parashikojnë që zotëruesit e obligacioneve të thirren në mbledhje nëpërmjet postës.

2. Me listimin e obligacioneve në ndonjë treg të rregulluar titujsh në Republikën e Shqipërisë, thirrja për zotëruesit e obligacioneve bëhet edhe përmes njoftimit në buletin ditor të tregut të titujve, ku janë listuar obligacionet.

Neni 21

Të drejtat e votës së zotëruesve të obligacioneve

1. Çdo obligacion mbart të drejtën e një vote në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve. Në rastin e certifikatës shumëfishe të obligacionit, zotëruesi i obligacionit ka të drejtën e aq votave sa është edhe numri i obligacioneve, që përfshihen në këtë certifikatë.

2. Kur mbi obligacionet është vendosur peng, e drejta e votës ushtrohet nga penglënësi i obligacioneve, përveçse kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjen e pengut ose në kushtet dhe afatet e huasë me obligacione, sipas programit të huasë. Për sa u takon elementeve civile, që rrjedhin nga obligacionet, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil mbi pengun.

3. Zotëruesi i obligacioneve ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve edhe nëpërmjet përfaqësimit. Në rast se obligacioni është në bashkëpronësi të disa personave, e drejta e votës ushtrohet nëpërmjet një përfaqësuesi.

4. Emetuesi nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës për obligacionet që ai vetë zotëron ose për obligacionet, mbi të cilat është vendosur pengu në favor të tij.

5. Përveçse kur ligji apo kushtet dhe afatet e obligacionit, sipas programit të huasë, përmbajnë dispozita të ndryshme për të drejtat e votës së zotëruesve të obligacioneve, dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, për asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, zbatohen, respektivisht, për të drejtat e votës së zotëruesve të obligacioneve, në përputhje me natyrën dhe qëllimin e obligacionit.

Neni 22

Vendimmarrja në mbledhjet e zotëruesve të obligacioneve

1. Vendimet e grupit të zotëruesve të obligacioneve janë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë zotëruesit e obligacioneve, të cilët përfaqësojnë 1/4 e vlerës totale të huasë me obligacione. Vendimet e zotëruesve të obligacioneve merren me shumicën absolute të votave, që përfaqësohen në mbledhje. Në rast se kuorumi i mësipërm prej 1/4 nuk arrihet, atëherë mbledhja shtyhet me 20 ditë pune nga data e mbledhjes të anuluar. Mbledhja e re quhet e mbledhur dhe mund të marrë vendime të vlefshme pavarësisht nga përfaqësimi i vlerës së obligacioneve.

2. Për çështjet, që parashikohen në nenin 18 të këtij ligji, vendimet e grupit të zotëruesve të obligacioneve quhen të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë zotëruesit e obligacioneve, që përfaqësojnë 2/3 e vlerës totale të obligacioneve. Në rast se kuorumi prej 2/3 nuk plotësohet, mbledhja shtyhet me 20 ditë pune nga data e mbledhjes të anuluar. Për të qenë e vlefshme mbledhja e re është e nevojshme të jenë të pranishëm zotëruesit e obligacioneve, të cilët përfaqësojnë 1/2 e vlerës totale të obligacioneve. Në rast se edhe ky kuorum nuk plotësohet, mbledhja rishtyhet për 20 ditë pune nga data e anulimit të mbledhjes së dytë dhe mbledhja e re, quhet e mbledhur dhe mund të merren vendime të vlefshme kur janë të pranishëm zotëruesit e obligacioneve, të cilët përfaqësojnë 1/4 e vlerës totale të obligacioneve. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, vendimet janë të vlefshme me shumicën e 2/3 të votave të pjesëmarrësve në mbledhje.

3. Programi i huasë mund të parashikojë kuorum dhe shumicë votash më të larta për marrjen e vendimeve në mbledhjet e zotëruesve të obligacioneve.

Neni 23

Rendi i ditës dhe procesverbali i mbledhjes

1. Zotëruesit e obligacioneve nuk vendosin për çështje, të cilat nuk janë përfshirë në rendin e ditës, me përjashtim të rasteve kur të gjithë zotëruesit e obligacioneve janë të pranishëm dhe asnjëri prej tyre nuk kundërshton shqyrtimin e çështjes në fjalë.

2. Zotëruesit e obligacioneve, që përfaqësojnë të paktën 1/20 e vlerës totale të obligacioneve, mund t'i kërkojnë personit, që ka thirrur mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve, sipas nenit 19 të këtij ligji, ta përfshijë çështjen në rendin shtesë të mbledhjes. Personi, që thërret mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve, sipas nenit 19 të këtij ligji, e pranon kërkesën për shtesë në rendin e ditës, në rast se kërkesa është paraqitur të paktën 10 ditë pune para datës së mbledhjes të thirrur. Përfshirja dhe njoftimi i çështjeve shtesë bëhen të paktën 5 ditë pune para mbledhjes të thirrur të zotëruesve të obligacioneve dhe është përgjegjësi e personit që ka thirrur mbledhjen.

3. Emetuesi mban procesverbalin, ku regjistrohen të gjitha vendimet e mbledhjeve të zotëruesve të obligacioneve.

Neni 24

Zbatimi i dispozitave plotësuese nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Përveç kur ligji apo kushtet e afatet e obligacionit, sipas programit të huasë, përmbajnë dispozita të ndryshme për vendimmarrjen e zotëruesve të obligacioneve, zbatohen dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare për asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, në përputhje me natyrën dhe qëllimin e obligacionit.

Neni 25

Mbulimi i shpenzimeve për zhvillimin e mbledhjes së zotëruesve të obligacioneve

1. Shpenzimet për veprimet përgatitore për mbledhjen dhe vendimet nga zotëruesit e obligacioneve, si dhe shpenzimet për publikimin e këtyre vendimeve mbulohen nga emetuesi.

2. Të gjitha shpenzimet e mbetura për veprimtarinë e grupit të zotëruesve të obligacioneve zbriten nga pagesa që emetuesi kryen për zotëruesit e obligacioneve, në përputhje me dispozitën përkatëse, të parashikuar, në kushtet dhe afatet e obligacionit, sipas programit të huasë.

KREU V

AGJENTI I ZOTËRUESVE TË OBLIGACIONEVE

Neni 26

Emërimi i agentit të zotëruesve të obligacioneve

1. Kushtet e obligacionit me ofertë publike, sipas programit të huasë, parashikojnë emërimin e agentit të zotëruesve të obligacioneve dhe të zëvendësit të tij. Ky agent dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga lista e kandidatëve (minimumi 5 persona), e cila përgatitet nga emetuesi. Emetuesi thërret mbledhjen e grupit të zotëruesve të obligacioneve brenda 30 ditëve nga data e miratimit të listës së kandidatëve nga Autoriteti, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji. Kriteret për hartimin e listës jepen me hollësi në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë. Në rastin e obligacionit me ofertë publike, si agent i zotëruesve të obligacioneve mund të caktohet vetëm një shoqëri komisionere ose një bankë, pasi është bërë verifikimi i licencës së saj, nga Banka e Shqipërisë, për të kryer veprimtari bankare dhe pasi është licencuar nga AMF-ja për të kryer transaksione me tituj.

2. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve apo zëvendësi i tij emërohen nga emetuesi, në rastet kur obligacioni është emetuar me ofertë private. Në këtë rast zbatohen dispozitat përkatëse të këtij kreu, me përjashtim të dispozitave të neneve 27 e 28 të këtij kreu, përkatësisht pikat 2, 3 e 4.

3. Agjenti vepron ekskluzivisht në interes të zotëruesve të obligacioneve dhe nuk mund të jetë edhe nënshkruesi i obligacioneve.

4. Dispozitat për sekretin bankar nuk zbatohen kundrejt agjentit të zotëruesve të obligacioneve, në lidhje me transaksionet me obligacione dhe me veprimet në llogaritë e kujdestarit.

Neni 27

Miratimi i listës së kandidatëve nga Autoriteti

1. Autoriteti miraton listën e kandidatëve, të hartuar nga emetuesi, në përputhje me pikën 1 të nenit 26 të këtij ligji, në rastin kur obligacionet shiten me ofertë publike dhe përpara marrjes së vendimit nga grupi i zotëruesve të obligacioneve për emërimin e agjentit të zotëruesve të obligacioneve.

2. Lista miratohet kur personat e propozuar janë licencuar nga Autoriteti. Në paraqitjen për miratim të kërkesës për kandidaturën e tyre në pozicionin e agjentit të zotëruesit të obligacioneve, personat e përfshirë në listën e sipërpërmendur duhet të dorëzojnë pranë AMF-së një deklaratë konfidenciale, nëpërmjet së cilës sigurojnë Autoritetin se nuk ekziston një konflikt interesash për ushtrimin e përgjegjësisë së tyre, si agjentë të zotëruesve të obligacioneve dhe mbrojtjen e interesave të zotëruesve.

3. Lista vlerësohet e miratohet nga Autoriteti, nëse brenda periudhës 30-ditore nuk refuzohet shprehimisht.

4. Në rast se lista nuk miratohet, Autoriteti duhet të paraqesë arsyet për vendimin e marrë, duke specifikuar cilët kandidatë nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në ligj dhe emetuesi duhet të hartojë një listë të re kandidatësh dhe t'ia dorëzojë përsëri AMF-së për miratim.

5. Në rastet kur shoqëritë komisionere apo bankat e licencuara nga AMF-ja për të kryer transaksione me tituj bëjnë deklaratë të rreme për konfliktin e interesit, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, AMF-ja vendos një gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

Neni 28

Shkarkimi dhe zëvendësimi i agjentit të zotëruesve të obligacioneve

1. Nëse obligacionet emetohen me ofertë private, zëvendësimi i agjentit të zotëruesve të obligacioneve kryhet vetëm nga emetuesi.

2. Nëse obligacionet emetohen me ofertë publike, agjenti i zotëruesve të obligacioneve dhe zëvendësi i tij mund të shkarkohen në çdo kohë, me vendim të grupit të zotëruesve të obligacioneve. Emetuesi thërret mbledhjen e grupit të zotëruesve të obligacioneve, në përputhje me dispozitat e nenit 20 të këtij ligji, me kërkesën e zotëruesve të obligacioneve, të cilët përfaqësojnë të paktën 1/20 e vlerës së obligacioneve apo serive respektive. Rendi i ditës së mbledhjes përmban listën e kandidatëve, të hartuar nga emetuesi, në përputhje me nenin 19 të këtij ligji. Emetuesi thërret mbledhjen e grupit të zotëruesve të obligacioneve brenda 10 ditëve pune nga data e miratimit të listës së kandidatëve nga Autoriteti. Në vijim, grupi i zotëruesve të obligacioneve emëron agjentin e ri dhe zëvendësin e tij, të cilin e zgjedh nga kandidatët e listës.

3. Në rast se agjenti i zotëruesve të obligacioneve apo zëvendësi i tij humbasin aftësinë për të vepruar, si rezultat i mospërputhjes me kërkesat e parashikuara nga ky ligj, atëherë ata detyrohen të japin dorëheqjen menjëherë, pas konstatimit të këtij fakti dhe të njoftojnë emetuesin. Në rast se ata kundërshtojnë dorëheqjen, emetuesi, me nismën e vet apo nëpërmjet kërkesës së zotëruesve të obligacioneve, të cilët përfaqësojnë të paktën 1/20 e vlerës së obligacioneve apo të serive respektive, mbledh grupin e zotëruesve të obligacioneve dhe i shkarkon ata nga detyra.

Rendi i ditës i mbledhjes përmban listën e re të kandidatëve, të përgatitur nga emetuesi, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji. Emetuesi detyrohet të thërrasë mbledhjen e grupit të zotëruesve të obligacioneve jo më vonë se 10 ditë pune nga data e miratimit të listës së re të kandidatëve nga Autoriteti dhe grupi i zotëruesve të obligacioneve emëron agjentin e ri nga kjo listë.

4. Shkarkimi i agjentit të zotëruesve të obligacioneve apo të zëvendësit të tij hyn në fuqi kur agjenti i ri apo zëvendësi janë emëruar nga grupi i zotëruesve të obligacioneve. Deri në përfundimin e shkarkimit të tij, agjenti i zotëruesve të obligacioneve mund të kryejë vetëm ato veprime, të cilat janë absolutisht të nevojshme dhe kanë lidhje me zëvendësimin e tij.

5. Pas emërimit, agjenti i ri i zotëruesve të obligacioneve njofton menjëherë emetuesin për këtë emërim.

Neni 29

Përgjegjësitë e agjentit të zotëruesve të obligacioneve

1. Përgjegjësitë e agjentit të zotëruesve të obligacioneve përcaktohen nga ligji, nga kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, si dhe nga vendimet e grupit të zotëruesve të obligacioneve.

2. Grupi i zotëruesve të obligacioneve mund të vendosë t'i japë përgjegjësi shtesë agjentit pasi merr miratimin e emetuesit. Vendimi përkatës i grupit të zotëruesve të obligacioneve duhet të specifikojë me përpikëri përgjegjësitë shtesë, që i jepen agjentit të zotëruesve të obligacioneve.

3. Përgjegjësitë, të cilat, me anë të këtij ligji, i janë dhënë grupit të zotëruesve të obligacioneve, nuk mund t'i ngarkohen, në asnjë mënyrë, agjentit.

4. Agjenti është përgjegjës për përfaqësimin në gjykatë dhe jashtë saj të grupit të zotëruesve të obligacioneve, përkundëjt emetuesit dhe personave të tretë.

Neni 30

Përfaqësimi i grupit të zotëruesve të obligacioneve

1. Veprimet e agjentit të zotëruesve të obligacioneve, edhe kur ato janë kryer përtej kompetencave të dhëna, janë të detyrueshme për zotëruesit e obligacioneve dhe për pasardhësit e tyre, përkundëjt emetuesit dhe personave të tretë, përveç rasteve kur emetuesi ose personat e tretë ishin në dijeni se agjenti po vepronte përtej kompetencave të veta. Në këtë rast, agjenti i zotëruesve të obligacioneve është përgjegjës për çdo dëm, që u shkaktohet atyre nga veprimet e tij.

2. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve ka fuqinë për të paraqitur në gjykatë kërkesë për fillim procedure penale apo procedure ekzekutimi.

3. Në rast se nuk parashikohet ndryshe në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, agjenti i kryen veprimet e parashikuara në pikën e mësipërme, në emrin e vet, pa qenë i nevojshëm një autorizim i veçantë nga grupi i zotëruesve të obligacioneve.

Neni 31

Pezullimi i veprimeve individuale të zotëruesve të obligacioneve

1. Zotëruesit e obligacioneve nuk mund t'i kundërvihen individualisht emetuesit, duke kryer veprime, të cilat janë përgjegjësi e agjentit, përveç rasteve kur ata janë autorizuar, në mënyrë specifike, nga grupi i zotëruesve të obligacioneve, për të vepruar në këtë mënyrë.

2. Dispozitat e pikës së mësipërme nuk cenojnë ushtrimin e të drejtave nga zotëruesi i obligacioneve përkundëjt kujdestarit, në llogaritë e të cilit mbahen titujt e zotëruesit të obligacioneve.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, pas maturimit të huasë, çdo mbajtës i obligacioneve mund të ushtrojë individualisht të drejtat e veta, që rrjedhin nga kushtet e obligacionit dhe të veprojë kundër emetuesit.

Neni 32

Përgjegjësia e agjentit të zotëruesve të obligacioneve

1. Në përputhje me kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, agjenti është përgjegjës kundëjt zotëruesve të obligacioneve për çdo veprim të kryer me keqbesim dhe neglizhencë. Përgjegjësia e agjentit të zotëruesit të obligacioneve përkundëjt emetuesit nuk mund të kufizohet vetëm nëpërmjet kushteve të përmbajtura në programin e huasë, për veprimet kryera me dashje ose nga pakujdesia.

2. Agjenti i zëvendësuar mban përgjegjësi për të gjitha veprimet apo mosveprimet deri në çastin e zëvendësimit nga agjenti i ri.

Neni 33

Tarifat e agentit të zotëruesve të obligacioneve

1. Tarifat dhe çdo lloj tjetër shpenzimi i kryer nga agjenti, në interes të zotëruesve të obligacioneve, i vihen në ngarkim emetuesit.

2. Në rastin e ekzekutimit të detyrueshëm, tarifat dhe çdo lloj tjetër shpenzimi i agentit të zotëruesve të obligacioneve, të kryera në interes të zotëruesve të obligacioneve, nga fillimi i procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm deri në mbledhjen e detyrimit, vlerësohen si shpenzime të ekzekutimit të detyrueshëm.

Neni 34

Përfundimi i marrëdhënies së përfaqësimit ndërmjet agentit dhe grupit të zotëruesve të obligacioneve

1. Marrëdhënia ndërmjet agentit dhe grupit të zotëruesve të obligacioneve përfundon në rastin kur vdes agjenti apo kur jep dorëheqjen, në rast të anulimit të emërimit ose të përfundimit të afatit të emërimit të agentit.

2. Kushtet e obligacionit, të përcaktuara në programin e huasë, mund të përfshijnë edhe shkaqe të tjera për përfundimin e kësaj marrëveshjeje.

KREU VI

SHPËRNDARJA E OBLIGACIONEVE

Neni 35

Mënyra dhe rregullat e shpërndarjes

1. Shpërndarja e obligacioneve kryhet nëpërmjet ofertës private apo publike.

2. Në rast të shpërndarjes së obligacioneve nëpërmjet ofertës publike zbatohen dispozitat e ligjit për titujt.

3. Emetuesi, i cili shpërndan obligacionet nëpërmjet ofertës publike, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të shpërndarjes, duhet të depozitojë kërkesën për listimin e obligacioneve në një treg të licencuar apo të rregulluar titujsh në Republikën e Shqipërisë.

4. Neglizhenca e emetuesit për listimin e obligacioneve, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, nuk sjell pavlefshmërinë e obligacioneve të emetuara. Emetuesi i kompenson çdo dëm zotëruesit të obligacioneve, për shkak të moskryerjes së veprimeve apo të pakujdesisë. Autoriteti vendos gjobë nga 150 000 deri në 5 000 000 lekë, në varësi të vlerës, kushteve dhe numrit të zotëruesve të obligacioneve.

Neni 36

Transferimi i obligacioneve

1. Obligacionet mund të transferohen lirisht, përveç kur parashikohet ndryshe në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë.

2. Obligacionet e listuara në një treg titujsh mund të tregtohen edhe në tregjet mbi banak, përmes kujdestarit, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt.

3. Kujdestari nuk krediton vlerën e obligacioneve në llogarinë e titujve të dematerializuar të përfituesit, pa debituar njëkohësisht llogarinë e obligacioneve të transferuesit, në përputhje me këtë ligj.

Neni 37

Blerja e obligacioneve të veta nga emetuesi

1. Emetuesi blen obligacionet e veta para maturimit, në përputhje me kushtet dhe afatet e huasë me obligacione, sipas programit të huasë me obligacione, ose me dispozitat e këtij ligji apo të legjisllacionit në fuqi.

2. Blerja e obligacioneve të veta vendoset nga organi kompetent i emetuesit, i cili është përgjegjës për marrjen e vendimeve për emetimin e obligacioneve. Vendimi i mësipërm mund të jetë i përgjithshëm dhe të autorizojë disa blerje, në shumë dhe kohë të ndryshme, qëllimin e blerjes së obligacioneve, shumën maksimale, që do të shpenzojë emetuesi për të realizuar blerjen, si dhe kohën e mënyrën e shpërndarjes së re të obligacioneve.

3. Për obligacionet e emetuara nëpërmjet ofertës publike, vendimi për blerjen e obligacioneve të veta nga emetuesi i njoftohet Autoritetit dhe publikohet menjëherë.

4. Emetuesi ka të drejtë të anulojë, në çdo kohë, obligacionet, të cilat i ka emetuar dhe blerë vetë, për sa kohë që këto obligacione janë të lira nga çdo barrë apo peng, në favor të një pale të tretë.

5. Emetuesi, me blerjen e obligacioneve të veta, nuk ushtron të drejtat e lidhura me këto obligacione.

Neni 38

Krijimi i garancive

Principal, interesi dhe shpenzimet e obligacioneve mund të sigurohen me çdo mjet sigurimi a garancie nga emetuesi apo nga persona të tretë, në përputhje me programin e huasë.

KREU VII

MATURIMI I HUASË SË OBLIGACIONEVE

Neni 39

Rrethanat e maturimit

Huaja e obligacionit maturohet me pagimin e tij ose me përfundimin e huasë.

Neni 40

Shlyerja e obligacioneve

1. Shlyerja e obligacioneve bëhet në datën e maturimit.

2. Përveç kur është parashikuar ndryshe në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, shlyerja e obligacioneve bëhet e plotë për të gjithë shumën. Shlyerja e parakohshme e obligacioneve është e mundur vetëm nëse përcaktohet në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë.

3. Në datën e maturimit, emetuesi është i detyruar të shlyejë vlerën nominale të obligacioneve. Nëse zotëruesi i obligacioneve e ka blerë obligacionin me çmim më të ulët se vlera nominale e tij, diferenca e krijuar nuk vlerësohet si interes për obligacionet.

4. Ushtrimi i të drejtave të konvertimit ose të këmbimit për obligacionet e konvertueshme a të këmbyeshme me aksione është shlyerje e obligacionit.

Neni 41

Çështje, të cilat lidhen me obligacionet që mbartin interes

1. Llogaritja e interesit përfundon me shlyerjen e obligacionit ose me pagimin e principalit të borxhit.

2. Paaftësia paguese e emetuesit nuk ndërpret llogaritjen e interesit për obligacionet.

Neni 42

Procedura për pagimin e obligacioneve në letër

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj apo në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, pagesa e obligacionit në letër kryhet në datën e maturimit, nëpërmjet dorëzimit të pakushtëzuar të certifikatës së obligacionit tek emetuesi dhe me evidentimin e pagesës në certifikatën e obligacionit.

2. Pagesa e pjesshme e obligacionit është e mundur nëpërmjet evidentimit në certifikatën e obligacionit ose nëpërmjet anulimit të certifikatës së parë të obligacionit dhe emetimit të një certifikate të re, për pjesën e mbetur, për t'u paguar nga principal.

Neni 43

Procedura për pagimin e obligacioneve të dematerializuara

1. Në datën e maturimit, zotëruesi i obligacioneve ka të drejtë t'i kërkojë kujdestarit pagesën e obligacionit. Kujdestari nuk paguan principalin dhe interesin, për aq kohë sa emetuesi nuk ka përmbushur, përkundëjt tij, çdo detyrim, që rrjedh nga programi i huasë.

2. Emetuesi lirohet nga çdo detyrim për t'ua paguar shumat përkatëse, për programin e huasë, zotëruesve të obligacioneve, kur këto detyrime ia paguan kujdestarit, në shumën dhe në kohën e duhur. Kujdestari është përgjegjës për pagimin e këtyre shumave të zotëruesit e obligacioneve apo të përfituesit të tjerë.

Neni 44

Veprimet e kujdestarit në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga emetuesi

1. Në rast se emetuesi nuk përmbush detyrimet përkundëjt kujdestarit, në mënyrën dhe kohën e duhur, sipas programit të huasë, atëherë zotëruesi i obligacioneve ka të drejtë të ngrejë pretendime vetëm ndaj emetuesit.

2. Kujdestari njofton menjëherë zotëruesit e obligacioneve dhe agjentin e tyre, si dhe Autoritetin pas njoftimit për mospërmbushjen, nga ana e emetuesit, të detyrimeve, të pagesës së shumave, në lidhje me huanë e obligacioneve. Kujdestari i jep agjentit të zotëruesve të obligacioneve informacionin e nevojshëm për ushtrimin e të drejtave të zotëruesve të obligacioneve përkundëjt emetuesit.

Neni 45

Përfundimi i programit të huasë me obligacione

1. Programi i huasë duhet të përcaktojë, shprehimisht dhe qartë, afatet, kushtet dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës së përfundimit të huasë, si nga emetuesi, edhe nga zotëruesi i obligacioneve.

2. Përfundimi i huasë lejohet në çdo kohë, kur ka arsye thelbësore.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe në kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, për obligacionet e emetuara nëpërmjet ofertës publike, e drejta për përfundimin e huasë ushtrohet nga agjenti i zotëruesve të obligacioneve me vendim të grupit të zotëruesve të obligacioneve. Kjo e drejtë nuk ushtrohet individualisht nga zotëruesit e obligacioneve.

4. Në rast se agjenti nuk ushtron të drejtën e përfundimit të huasë brenda afatit të përcaktuar nga grupi i zotëruesve të obligacioneve, atëherë zotëruesit e obligacioneve kanë të drejtë të fillojnë procedurën e zëvendësimit të agjentit, gjë për të cilën detyrimisht njoftojnë Autoritetin. AMF-ja vendos gjobë deri në 500 000 lekë ndaj agjentit të zotëruesve të obligacioneve, në rast shkeljeje të detyrimeve të tij.

KREU VIII

REGJIMI TATIMOR I OBLIGACIONEVE

Neni 46

Përfundimi nga taksat

1. Transaksionet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat.

2. Përfundohen nga çdo taksë tjetër apo tatim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, transaksionet apo veprimet e mëposhtme:

- a) emetimi i obligacionit, sipas këtij ligji;
- b) vendosja e garancive në favor të zotëruesve të obligacioneve;
- c) të gjitha marrëveshjet e parashikuara në këtë ligj, si dhe çdo marrëveshje shtesë apo çdo veprim e regjistrim i këtyre akteve në regjistrat publikë, sa herë është e nevojshme;
- ç) emetimi i përkohshëm apo i përhershëm i titujve të obligacioneve;
- d) shpërndarja dhe qarkullimi i obligacioneve;
- dh) pagimi i pricipalit të obligacioneve dhe i pretendimeve tregtare, që lidhen me këto obligacione;
- e) në përgjithësi, ushtrimi i të drejtave, që rrjedhin nga obligacionet e lëshuara në përputhje me ligjin në fuqi, ose nga pretendimet tregtare, që lidhen me këto obligacione;
- ë) transferimi i obligacioneve, i kryer brenda apo jashtë një tregu të licencuar titujsh;
- f) vendosja e barrëve dhe e pengjeve për obligacionet.

PJESA II OBLIGACIONET E EMETUARA NGA SHOQËRITË AKSIONARE

KREU I VENDIMI PËR EMETIMIN E OBLIGACIONEVE

Neni 47

Kompetenca e këshillit mbikëqyrës për emetimin e obligacioneve

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vendimi për emetimin e obligacioneve merret nga organet përkatëse të shoqërisë aksionare, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
2. Vendimi për emetimin e obligacioneve depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 48

Kompetenca e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, për emetimin e obligacioneve

Asambleja e përgjithshme e aksionarëve të emetuesit ka të drejtën ekskluzive të emetimit:

- a) të obligacioneve të konvertueshme;
- b) të obligacioneve me pjesëmarrje;
- c) të obligacioneve të këmbyeshme.

Neni 49

Elementet thelbësore të vendimit për emetimin e obligacioneve

Përveçse kur përcaktohet ndryshe në dispozitat e ligjit për titujt, vendimi për emetimin e obligacioneve duhet të përmbajë, të paktën, elementet e mëposhtme:

- a) shumën valutore të obligacioneve;
- b) llojin, vlerën nominale dhe numrin e obligacioneve;
- c) asetet e përdorura për mbulimin e obligacioneve;
- ç) normën e interesit të huasë dhe mënyrën e llogaritjes të saj;
- d) përfitimet dhe mjetet për sigurimin apo garancitë e ofruara në favor të pretendimeve të zotëruesve të obligacioneve, që rrjedhin nga obligacionet;
- dh) emërimin e kujdestarit ose caktimin e çdo personi tjetër, të autorizuar për të kryer pagesat, kur është e nevojshme;
- e) kohën dhe procedurën për shlyerjen e obligacioneve dhe përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga obligacionet;
- ë) procedurën e përfundimit dhe kushtet për shpërndarjen e obligacioneve.

Neni 50

Zbatimi i dispozitave plotësuese të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, për çështjet, që kanë të bëjnë me vendimin e këshillit mbikëqyrës apo të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve, për emetimin e obligacioneve, zbatohen dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 51

Zbatimi i dispozitave për anëtarët e drejtorisë

Çdo dispozitë e këtij ligji, për të drejtat, detyrat dhe autorizimet e këshillit mbikëqyrës zbatohet edhe për anëtarët e drejtorisë, kur emetuesi ka sistemin e drejtimit me dy nivele, sipas neneve përkatëse të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

KREU II

GRUPI I ZOTËRUESVE TË OBLIGACIONEVE

Neni 52

Kufijtë e përgjegjësi të zotëruesve të obligacioneve

Grupi i zotëruesve të obligacioneve nuk ka të drejtë të vendosë për t'i konvertuar obligacionet në aksione.

Neni 53

Rregulla për parandalimin e konfliktit të interesit

1. Personi apo subjekti, i cili zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të paktën 1/4 e kapitalit aksionar të emetuesit, nuk ka të drejtë të votojë në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve.

2. Zotëruesi i obligacionit nuk mund të përfaqësohet në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve nga:

- a) emetuesi apo një filial i tij, sipas kuptimit të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;
- b) një person, i cili vepron për llogari të shoqërive të përmendura në shkronjën "a" të kësaj pike;
- c) një person, i cili ka dalë garant apo ka vendosur garanci a mjet tjetër sigurimi për obligacionet, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja apo të afërmit, deri në brezin e dytë;
- ç) administratorët dhe punonjësit e emetuesit a të filialeve të tij, apo çdo person i autorizuar të përfaqësojë a të mbikëqyrë emetuesin a filialet e tij, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja dhe të afërmit, deri në brezin e dytë;
- d) administratorët dhe punonjësit e emetuesit a të filialeve të tij, apo çdo person i autorizuar të përfaqësojë a të mbikëqyrë personat e përcaktuar në shkronjën "c" të kësaj pike, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja dhe të afërmit, deri në brezin e dytë.

3. Personat e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund të marrin pjesë, me të drejtë vote, në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve, nëse janë zotërues të obligacioneve, si dhe nuk zotërojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, 1/4 e kapitalit aksionar të emetuesit.

4. Emetuesi nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës për obligacionet që ai zotëron, si dhe për obligacionet, për të cilat është vendosur peng në favor të tij.

5. Filiali i emetuesit nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës për obligacionet, për të cilat është vendosur peng në favor të tij. Ndalimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për personat e përmendur në shkronjat "b", "c" e "ç" të pikës 2 të këtij neni për obligacionet, për të cilat është vendosur peng në favor të tyre.

KREU III
AGJENTI I ZOTËRUESVE TË OBLIGACIONEVE

Neni 54

Kufizime për agjentin e zotëruesve të obligacioneve

1. Nuk mund të emërohen agjentë të zotëruesve të obligacioneve personat e mëposhtëm:
 - a) emetuesi apo filial i tij, sipas kuptimit të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;
 - b) personi, i cili ka dhënë mjete për sigurimin e ekzekutimit të detyruar të detyrimit për obligacionet;
 - c) personi, i cili vepron në emër të subjektit të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike;
 - ç) administratorët dhe punonjësit e emetuesit a të filialeve të tij apo çdo person i autorizuar të përfaqësojë a të mbikëqyrë emetuesin apo filialet e tij, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja dhe të afërmit, deri në brezin e dytë;
 - d) administratorët dhe punonjësit apo çdo person tjetër, i autorizuar të përfaqësojë a të mbikëqyrë personat e përmendur në shkronjën “b” të kësaj pike, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja apo të afërmit, deri në brezin e dytë;
 - dh) shoqëria, e cila ka emetuar aksione, obligacione ose tituj të tjerë të transferueshëm, të cilët janë të këmbyeshëm brenda kuadrit të obligacioneve, përveçse kur shumica e vlerës së obligacioneve dhe e titujve të transferueshëm, të emetuar nga ky subjekt, i cili do të emërohet si agjent i zotëruesve të obligacioneve, nuk tejkalon kufirin 5 për qind të vlerës totale të aksioneve, obligacioneve dhe të titujve të tjerë të transferueshëm, që ofrohen në kuadër të këmbimit. Për përcaktimin e kufirit të mësipërm, mbahet parasysh vlera e titujve të transferueshëm, në çastin e emërimit të agjentit.
2. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve duhet të japë dorëheqjen në rast se, pas emërimit të tij, ndodhet në njërin nga rrethanat sipërpërmendura. Zëvendësimi i tij kryhet në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.

Neni 55

Pjesëmarrja në asamblenë e përgjithshme të aksionarëve

1. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të emetuesit, në rast se rendi i ditës përmban çështje që lidhen me interesat e grupit të zotëruesve të obligacioneve. Për këtë qëllim, emetuesi njofton agjentin për rendin e ditës të të gjitha mbledhjeve të kësaj asambleje.
2. Agjenti i kërkon këshillit mbikëqyrës të emetuesit informacionin e nevojshëm, për të shqyrtuar dhe vlerësuar çështjet e mësipërme, sipas të njëjtave kushte dhe afate, të zbatueshme për aksionarët. Këshilli mbikëqyrës i emetuesit mund të refuzojë dhënien e informacionit vetëm për shkaqe thelbësore. Refuzimi jepet me shkrim dhe argumentohet në mënyrë të mjaftueshme.

KREU IV
OBLIGACIONET E KONVERTUESHME

Neni 56

**Vendimi për emetimin e obligacioneve
të konvertueshme në aksione**

1. Vendimi i asamblesë së përgjithshme të emetuesit merret me shumicë prej 2/3 të votave të aksionarëve, të pranishëm ose të përfaqësuar, të cilët zotërojnë 2/3 e kapitalit të paguar të emetuesit. Në rast se kuorumi prej 2/3 nuk plotësohet, atëherë mbledhja e asamblesë së përgjithshme caktohet brenda 20 ditëve pune nga data e mbledhjes së anuluar dhe mbledhja e re është e vlefshme kur janë të pranishëm aksionarët, të cilët përfaqësojnë 1/2 e kapitalit të paguar. Në rast se edhe kuorumi i mësipërm nuk plotësohet, atëherë mbledhja e asamblesë së përgjithshme caktohet brenda 20 ditëve

pune nga data e mbledhjes të anuluar dhe mbledhja e re vlerësohet e vlefshme kur janë të pranishëm aksionarët, të cilët përfaqësojnë 1/4 e kapitalit të paguar. Në të gjitha rastet, vendimet merren me shumicën e 2/3 të votave të aksionarëve të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve.

2. Përveç përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji, vendimi i asamblesë së përgjithshme të aksionarëve për emetimin e obligacioneve të konvertueshme duhet të përfshijë edhe elementet e mëposhtme:

a) mënyrën e ushtrimit të së drejtës së konvertimit;

b) çmimin ose raportin e konvertimit të obligacioneve apo kufijtë e konvertimit të tyre.

3. Në rast se ekzistojnë disa lloje aksionesh, atëherë vendimi i asamblesë së përgjithshme të aksionarëve për emetimin e obligacioneve të konvertueshme duhet të miratohet nga aksionarët, llojet e aksioneve të cilëve preken nga vendimi i mësipërm. Kuorumi, që miraton vendimin për llojin apo llojet e aksionarëve, të cilët preken nga vendimi i mësipërm, merret me kuorumin dhe shumicën e votave, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Vendimi për emetimin e obligacioneve të konvertueshme regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 57

Rregulla për pagimin e vlerës së obligacioneve të konvertueshme

1. Obligacionet e konvertueshme, të përbëra nga aksione, nuk mund të emetohen në vlerë më të ulët se vlera nominale e aksionit të emetuesit.

2. Vlera e obligacioneve të konvertueshme në shpërndarje paguhet plotësisht përpara konvertimit të obligacionit.

3. Kur ushtrohet e drejta e konvertimit, aksionet e përfituara kanë vlerë nominale të barabartë ose më të vogël se çmimi i emetimit.

Neni 58

Vërtetimi i pagimit të vlerës së obligacionit dhe çmimit të konvertimit

Për rritjen e kapitalit aksionar të emetuesit, nëpërmjet konvertimit të obligacioneve në aksione, këshilli mbikëqyrës vërteton nëse është kryer pagesa e vlerës së obligacioneve dhe e çdo çmimi të konvertimit. Për sa më sipër, zbatohen dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, për rritjen e kapitalit aksionar, në mënyrë të ngjashme me natyrën dhe qëllimin e obligacionit.

Neni 59

Të drejtat e parablerjes

1. Në rast të emetimit të obligacioneve të konvertueshme në aksione apo të obligacioneve me pjesëmarrje, aksionarët e emetuesit gëzojnë të drejtën e parablerjes së këtyre obligacioneve.

2. E drejta e parablerjes ushtrohet në përputhje me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, që rregullojnë të drejtën e parablerjes së aksioneve, në rastet e rritjes së kapitalit aksionar, me emetimin e aksioneve të reja.

3. Asambleja e përgjithshme vendos për përjashtimet nga e drejta e parablerjes, në përputhje me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, të cilat rregullojnë përjashtimet në ushtrimin e së drejtës së parablerjes, në emetimin e aksioneve të reja.

Neni 60

Të drejtat e konvertimit

1. Të drejtat e konvertimit ushtrohen nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

a) për obligacionet e prurësit, nga zotëruesi i titullit;

b) për obligacionet e regjistruara në letër, nga zotëruesi i titullit, i cili është regjistruar në regjistrin e emetuesit;

c) për obligacionet e dematerializuara, nga përfituesi i llogarisë së titujve të dematerializuar, që mbahet nga kujdestari, me të cilën mbahen obligacionet e konvertueshme. Në përputhje për sa më sipër, kujdestari i lëshon emetuesit një vërtetim.

2. Të drejtat e konvertimit nuk mund të transferohen të ndara nga obligacionet, por vetëm së bashku me to.

3. Asnjë organ i emetuesit nuk mund të revokojë të drejtat e konvertimit.

KREU V OBLIGACIONET E KËMBYESHME

Neni 61

Ushtrimi i së drejtës së këmbimit nga zotëruesi i obligacioneve

Programi i huasë duhet të përshkruajë saktë dhe qartë llojin dhe sasinë e titujve të transferueshëm, të cilët këmbehen, si dhe çdo çështje tjetër, që lidhet me përmbajtjen e procedurën e ushtrimit të së drejtës së këmbimit nga zotëruesi i obligacioneve.

Neni 62

Vlera e obligacioneve dhe detyrimet e emetuesit

1. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në statutin e emetuesit, emetimi i obligacioneve të këmbyeshme nuk është objekt kufizimi sasior.

2. Emetuesi detyrohet të sigurojë, se me ushtrimin e së drejtës së këmbimit nga zotëruesi i obligacioneve, titujt, që do të transferohen te këta të fundit, janë të disponueshëm, në përputhje me kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë dhe të lirë nga çdo barrë.

3. Kushtet e obligacionit, sipas programit të huasë, përshkruajnë saktë dhe qartë masat, që janë marrë nga emetuesi, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve për transferimin te zotëruesit e obligacioneve të titujve që do të këmbehen. Veçanërisht ato përshkruajnë nëse titujt që transferohen, në përmbushje të ushtrimit të së drejtës së këmbimit nga zotëruesit e obligacioneve, zotërohen tashmë apo do të zotërohen nga emetuesi a nga ndonjë person i tretë, si dhe mënyrën e kohëzgjatjen e zotërimit të tyre.

KREU VI OBLIGACIONET ME PJESËMARRJE

Neni 63

Kuptimi dhe përmbajta e obligacioneve me pjesëmarrje

1. Asambleja e përgjithshme e aksionarëve të emetuesit vendos për emetimin e obligacioneve me pjesëmarrje, sipas dispozitave të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Vendimi i asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të emetuesit merret sipas kuorumit të anëtarëve dhe me shumicën e votave, të parashikuar në nenin 49 të këtij ligji.

2. Obligacionet me pjesëmarrje u japin zotëruesve të obligacioneve të drejtën për të marrë, përveç interesit, edhe përqindje të caktuar të fitimit të emetuesit ose përfitim shtesë, të cilat kushtëzohen nga masa e prodhimit, e fitimeve apo e rezultatit ekonomik, në përgjithësi, të emetuesit, sipas një përcaktimi specifik dhe të qartë, në obligacionet, sipas programit të huasë me obligacione. Kushtet e obligacionit sipas programit të huasë përcaktojnë edhe çështjet përkatëse për përparësinë e pjesëmarrjes në fitime të zotëruesve të obligacioneve.

PJESA III
DISPOZITA TË VEÇANTA PËR OBLIGACIONET E EMETUARA NGA QEVERIA VENDORE
KREU I
EMETIMI I OBLIGACIONIT, DETYRIMET E EMETUESIT

Neni 64

Obligacionet afatshkurtra dhe afatgjata

1. Qeveria vendore ka të drejtë të emetojë obligacione afatshkurta dhe afatgjata, në përputhje me dispozitat e ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore.

2. Përveç dispozitave përkatëse të ligjit për huamarrjen e qeverisjes vendore, obligacionet e emetuara nga qeveria vendore duhet të përmbajnë edhe elementet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 65

Kompetencat për emetimin e huasë së obligacioneve

Vendimi për emetimin e obligacioneve merret nga organet kompetente vendimmarrëse të qeverisë vendore, në përputhje me ligjin për huamarrjen e qeverisjes vendore.

Neni 66

Detyrimet e emetuesit

1. Qeveria vendore, e cila ka emetuar obligacione, i nënshtrohet për çdo vit financiar auditimit të detyrueshëm nga auditi i jashtëm, i autorizuar.

2. Raporti i auditit të jashtëm, të autorizuar për auditimin e mësipërm, hartohet për çdo vit financiar, deri në datën 30 prill të vitit financiar pararendës dhe vihet në dispozicion të zotëruesve të obligacioneve me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e emetuesit.

KREU II

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT, TË DREJTAT E AGJENTIT TË
ZOTËRUESVE TË OBLIGACIONIT

Neni 67

Rregulla për parandalimin e konfliktit të interesit

1. Zotëruesi i obligacioneve nuk mund të përfaqësohet në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve nga:

a) emetuesi apo sipërmarrja, e cila drejtohet nga emetuesi apo autoritete bashkëqeverisëse;
b) personi, i cili vepron për llogari të personave të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) personi, i cili ka dhënë garanci apo mjete të tjera sigurimi për obligacionet, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja apo të afërmit e tij, deri në brezin e dytë;

ç) punonjës të emetuesit apo çdo person tjetër, i autorizuar për ta përfaqësuar a mbikëqyrur emetuesin, ose sipërmarrje e drejtuar nga emetuesi, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja apo të afërmit e tij, deri në brezin e dytë.

2. Personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të marrin pjesë, me të drejtë vote, në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve, nëse ata janë vetë zotërues të obligacioneve.

3. Emetuesi nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës për obligacionet, që ai zotëron, si dhe për obligacionet, mbi të cilat është vendosur peng në favor të tij.

4. Sipërmarrja, e drejtuar nga emetuesi apo nga një autoritet bashkëqeverisës, pjesë e të cilit është emetuesi, nuk ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e votës për obligacionet, mbi të cilat është vendosur peng në favor të tij. Kufizimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për ushtrimin e së drejtës

së votës për personat e përshkruar në shkronjat “b”, “c” e “ç” të pikës 1 të këtij neni, për obligacionet, mbi të cilat është vendosur peng në favor të tyre.

Neni 68

Kufizime për agjentin e zotëruesve të obligacioneve

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 26 të këtij ligji, nuk mund të emërohen agjentë të zotëruesve të obligacioneve, personat e mëposhtëm:

a) emetuesi ose sipërmarrja e drejtuar nga emetuesi a nga një autoritet bashkëqeverisës, pjesë e të cilit është emetuesi;

b) personi, i cili vepron për llogari të personave të përmendur në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 67 të këtij ligji;

c) punonjës të emetuesit apo çdo person tjetër, i autorizuar për të përfaqësuar apo mbikëqyrur emetuesin, ose një sipërmarrje e drejtuar nga emetuesi, si dhe bashkëshorti/bashkëshortja e tij apo të afërmit e tij, deri në brezin e dytë.

2. Agjenti detyrohet të dorëhiqet, në rast se pas emërimit të tij gjendet në ndonjërin nga rrethanat e mësipërme. Zëvendësimi i tij kryhet në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.

Neni 69

Të drejtat e agjentit të zotëruesve të obligacioneve

1. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve ka të drejtë të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në organet e administrimit të emetuesit, në rast se rendi i ditës përmban çështje, që lidhen me interesat e grupit të zotëruesve të obligacioneve. Për këtë arsye, emetuesi njofton agjentin për rendin e ditës të të gjitha mbledhjeve të organeve të administrimit dhe e fton atë të marrë pjesë në mbledhje.

2. Agjenti i zotëruesve të obligacioneve ka të drejtë të kërkojë informacionin e nevojshëm, për të shqyrtuar e vlerësuar çështjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, sipas të njëjtave kushte dhe afate për përdorimin e informacionit nga anëtarët e organeve të administrimit të qeverisë vendore.

Neni 70

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6306, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 159, datë 15.10.2009

PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR.8340/1, DATË 6.5.1998 “PËR RREGULLIMIN E PASOJAVE, QË KANË RRJEDHUR NGA ZBATIMI I DEKRETIT NR.204, DATË 5.6.1992 “PËR PASURINË E SINDIKATAVE””

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ligji nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave, që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave””, shfuqizohet.

Neni 2

Për marrëdhëniet e detyrimit, të krijuara ndërmjet sindikatave dhe të tretëve, si dhe për kontratat e lidhura ndërmjet tyre, për shkak të ushtrimit të tagrave të gëzimit dhe të posedimit prej sindikatave mbi pasuritë shtetërore të paluajtshme, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 3

Ekzekutimi i detyrimit, që rrjedh nga një marrëdhënie detyrimi ndërmjet sindikatës, në cilësinë e kreditorit dhe një pale të tretë, në cilësinë e debitorit, kryhet në favor të shtetit.

Neni 4

1. Për identifikimin e pasurive të sindikatave ngarkohet Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, e cila kryen:

a) inventarizimin e pasurive shtetërore, të luajtshme dhe të paluajtshme, në administrim të sindikatave;

b) identifikimin e marrëdhënieve të krijuara me të tretët për këto pasuri;

c) identifikimin e objekteve të kulturës, të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilat kanë kaluar apo duhet të kalonin në pronësi të qeverisjes vendore, sipas nenit 7 të ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998;

ç) regjistrimin e pronave të paluajtshme të shtetit në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, në përputhje me ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar.

2. Këshilli i Ministrave, bazuar në parimet e administrimit të pronës shtetërore, miraton, me vendim, procedurat për veprimtarinë dhe raportimin Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, në zbatim të pikës 3 të këtij neni.

3. Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike duhet të përfundojë këtë detyrë brenda 3 muajve nga data e daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave dhe raporton për këtë në Këshillin e Ministrave.

Neni 5

1. Këshilli i Ministrave me vendim cakton organin shtetëror përgjegjës për administrimin e pronave të paluajtshme, të inventarizuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe përgjegjësitë e tij, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, duke bërë shënimin përkatës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

2. Këshilli i Ministrave, për nxjerrjen e vendimit, bazohet në parimet e administrimit të pronës shtetërore, veçanërisht për ruajtjen e destinacionit apo të qëllimit të përdorimit të saj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6307, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr. 10 160, datë 15.10.2009

PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PËR FUNKSIONARËT PUBLIKË DHE NËPUNËSIT CIVILË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

Funksionarëve publikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë, në përmbushje të detyrimeve dhe të përgjegjësiave të ngarkuara nga detyra që kryejnë, shërbimi i transportit u mbulohet nga buxheti i institucioneve përkatëse, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 2

Kategoritë e përfituesve

Kategoritë e përfituesve nga ky ligj janë:

1. Kategoria e parë, ku përfshihen të gjithë funksionarët publikë, të përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, të cilëve u caktohen automjet dhe shofer, në dispozicion të përhershëm, shpenzimet e të cilëve përballohen nga buxheti i institucionit përkatës. Përgjegjës për mirëmbajtjen e automjeteve janë, sipas rregullave në fuqi, drejtuesit, të cilët e kanë në ngarkim automjetin.

2. Kategoria e dytë, ku përfshihen të gjithë funksionarët e përcaktuar në lidhjet 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij, të cilëve u caktohet një përfitim financiar mujor, sipas vlerës së përcaktuar në po të njëjtën lidhje, për shërbime transporti, në përmbushje të

detyrave të tyre funksionale. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet miratohet me vendim të Kuvendit, në bazë të distancës me zonën që ai përfaqëson, por, në nivelin mesatar, kjo masë nuk mund të jetë më shumë se 45 000 (dyzet e pesë mijë) lekë në muaj.

3. Kategoria e tretë, ku përfshihen funksionarë të nivelit drejtor i përgjithshëm/titullar institucioni/titullar i ndërmarrjeve publike, që nuk përfshihen në kategorinë e parë dhe në të dytën, të cilët do të marrin një përfitim financiar mujor në përputhje me veprimtarinë e tyre, por jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj. Kjo kategori dhe masa e këtij përfitimi mujor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Të gjithë funksionarët e tjerë, të cilët nuk janë pjesë e lidhjeve 1, 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij ligji, por që, sipas akteve ligjore në fuqi, kanë në dispozicion automjet dhe shofer, trajtohen sipas kategorisë së dytë, me një përfitim financiar mujor 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

5. Kategoria e katërt, ku përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive, institucioneve qendrore dhe të varësisë, të cilëve shërbimi i transportit, për të përmbushur detyrat e tyre funksionale, do t'u ofrohet nga institucioni përkatës. Ky shërbim do të kryhet me mjetet në përdorim të institucionit, të cilat përdoren, në çdo rast, vetëm me autorizim apo urdhër të titullarit, për shërbime, sipas një programi të miratuar prej tij.

Neni 3

Kompensimi për përdorim vetjak të mjeteve publike

Funksionarët publikë, të klasifikuar në kategorinë e parë, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, që kanë të drejtë të përdorin mjetet, nëse dëshirojnë t'i përdorin ato edhe për qëllime, që nuk lidhen me funksionin apo detyrën që ushtrojnë, si për shembull në ditë pushimi të festave zyrtare, gjatë fundjavave, si dhe në ditët e lejes së pushimit vjetor, duhet të derdhin në drejtoritë e përgjithshme të financave, burimeve njerëzore dhe shërbimeve të institucioneve që përfaqësojnë, një shumë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh në vit.

Neni 4

Përjashtimi nga përdorimi i automjeteve të institucionit

Personat, që do të trajtohen sipas nenit 2 pikat 2 e 3 të këtij ligji, nuk mund të trajtohen me shërbimin e ofruar sipas pikës 5 të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 5

Masa e përfitimit mujor

Masa e përfitimit financiar mujor, për të gjitha kategoritë, që e përfitojnë atë sipas pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 2 të këtij ligji, do të indeksohen me inflacionin vjetor, por jo më shumë se 3(tre) për qind në vit.

Masa e indeksimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Automjetet në dispozicion të institucioneve

Numri i automjeteve në dispozicion të çdo ministrie, institucioni qendror apo dhe të varësisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Sanksionet

Përdorimi i automjeteve për shërbime jashtë detyrave funksionale përbën kundërvajtje administrative dhe shkelje të etikës profesionale dhe dënohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 8
Dispozita kalimtare

Të gjitha automjetet e tepërta, në dispozicion të ministrive, institucioneve qendrore dhe të varësisë shiten me ankand, në të cilin e drejta e parablerjes u takon funksionarëve të kategorive të trajtuara në pikat 2 e 3 të nenit 2 të këtij ligji. Ministrinë, institucionet qendrore dhe të varësisë ngrenë, me urdhër të titullarit, komisionet e organizimit të procedurave të ankandit me jo më pak se 5 anëtarë. Rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit dhe kriteret e vlerësimit të pronës, që do të nxirret në ankand, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9
Shfuqizime

Pika 4 e nenit 14 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6308, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Lidhja 1: Funksione, të cilat do të kenë mjete transporti në dispozicion

Nr.	Funksionet
1	President
2	Kryetar i Kuvendit
3	Nënkryetar i Kuvendit
4	Kryeministër
5	Zëvendëskryeministër
6	Ministër
7	Prokuror i Përgjithshëm
8	Avokat i Popullit
9	Drejtor i SHISH-it
10	Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit
11	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
12	Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
13	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë
14	Kryetar i partisë në mazhorancë dhe më të madhe opozitare
15	Kryetar i bashkisë së kryeqytetit
16	Kryetar i Gjykatës së Lartë
17	Kryetar i Gjykatës së Krimeve të Rënda
18	Kryetar i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda
19	Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda
20	Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda
21	Guvernator i Bankës së Shqipërisë
22	Komandant i Gardës së Republikës

Lidhja 2: Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit, për disa funksione në institucionet e pavarura dhe pushtetin vendor

Nr.	Kategoria e dytë	Përfitimi financiar mujor (në lekë)
1	Deputet	
2	Kryetar i bashkisë qendër qarku	45 000
3	Kryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	35 000
4	Kryetar i Komisionit të Konkurrencës	35 000
5	Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale	35 000
6	Kryetar i Komisionit të Shërbimit Civil	35 000
7	Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	35 000
8	Kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	35 000
9	Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë	35 000
10	Kryetar i Entit Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura	35 000
11	Kryetar i Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive	35 000
12	Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	35 000
13	Kryetar i Akademisë së Shkencave	35 000
14	Rektor i universiteteve	35 000
15	Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	35 000
16	Kryetar i Këshillit të Qarkut	35 000
17	Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese	35 000
18	Anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	35 000
19	Kryetar i Gjykatës Shkallës së Parë/Kryetar i Gjykatës së Apelit	35 000
20	Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Apelit	35 000
21	Kryetar bashkie	30 000
22	Dekan i universiteteve	20 000
23	Avokat i Prokurimit Publik	30 000

Lidhja 3: Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit, për disa funksione në institucionet e varësisë së Këshillit të Ministrave dhe ministrive

Nr.	Kategoria e dytë	Përfitimi financiar mujor (në lekë)
1	Zëvendësministër	35 000
2	Sekretar i Përgjithshëm në Presidencë/Kuvend/Kryeministri	35 000
3	Drejtor Kabineti në Presidencë/ Kuvend /Kryeministri	35 000
4	Këshilltar në Presidencë/ Kuvend /Kryeministri	35 000
5	Gjeneral lejtant dhe gjeneral major	20 000
6	Komandant i Forcave të Armatosura tokësore, detare, ajrore	20 000
7	Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve	20 000
8	Titullar i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	20 000
9	Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	20 000
10	Kryetar i Komitetit Shtetëror të Kulteve	20 000
11	Drejtor i Përgjithshëm i Doganave	20 000
12	Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve	20 000
13	Titullar i Zyrës Qendrore të ALUIZN-it	20 000
14	Sekretar i Përgjithshëm/drejtor kabineti në ministri	15 000
15	Gjeneral Brigade	15 000
16	Prefekt	15 000
17	Avokat i Përgjithshëm i Shtetit	20 000
18	Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile	15 000
19	Drejtues i policisë së qarkut	15 000
20	Drejtues i SHISH-it të qarkut	15 000
21	Drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së	15 000
22	Drejtor i Përgjithshëm i ISKSH-së	15 000
23	Nënkryetar/Sekretar i Akademisë së Shkencave	20 000

LIGJ
Nr.10 161, datë 15.10.2009

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHTETIT TË VITIT 2008

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit i vitit 2008, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

Në milionë lekë

1. Buxheti i Shtetit

- Të ardhurat, gjithsej	243 416
- Shpenzimet, gjithsej	305 007
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore	
- Të ardhurat	66 552
- Shpenzimet	65 823
3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore	
- Të ardhurat	10 984
- Shpenzimet	10 376
4. Deficiti buxhetor.....	(60 254)
5. Financimi i deficitit buxhetor.....	60 254
I brendshëm.....	24 417
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme, neto).....	18 012
- Kredi nga Banka e Shqipërisë.....	3 000
- Bono thesari.....	(7 986)
- Obligacione qeveritare 2/3/5/7-vjeçare	22 998
B. Të ardhura nga privatizimi.....	5 538
C. Të tjera	867
- Ndryshimi i gjendjes së arkës.....	(4 268)
- Të tjera.....	5 135
Financimi i jashtëm, neto.....	35 837

Nga i cili:

- Mbështetje buxhetore.....	0
-----------------------------	---

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6309, datë 28.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

VENDIM
Nr.1020, datë 14.10.2009

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS,
AKREDITUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit European, për rregullat e bashkëpunimit të asistencës për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi European, (që në vijim do të quhet “Agjenci”), si një institucion publik buxhetor, në varësi të Ministrit të Financave, i cili është zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO).

2. Agjencia ka objektiv të veprimtarisë auditimin dhe kontrollin e zbatimit të programeve të asistencës, akredituar nga Bashkimi European Republikës së Shqipërisë, bazuar në detyrimet ndërkombëtare, që ajo do të ndërmarrë.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë agjencia është:

a) funksionalisht e pavarur nga të gjithë aktorët në sistemin e menaxhimit të decentralizuar të asistencës, së akredituar nga BE-ja, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranura;

b) përgjegjëse për verifikimin dhe funksionimin efikas e të shëndoshë të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të asistencës.

4. Agjencia kryen funksionet e mëposhtme:

a) Harton dhe zbaton planin dhe strategjinë vjetore të verifikimit e auditimit të të gjitha strukturave të ngarkuara dhe të përfshira në sistemin e zbatimit të këtyre programeve. Plani vjetor i punës për auditin i dorëzohet zyrtarit kombëtar të autorizuar (ZKA/NAO) dhe Komisionit European para fillimit të vitit ushtrimor.

b) Auditon e verifikon efikasitetin e menaxhimit dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në strukturat përgjegjëse, për zbatimin e këtyre programeve, për të siguruar shpenzimin e fondeve të akredituara nga Bashkimi European, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) Auditon dhe verifikon besueshmërinë e informacionit kontabël, që i dërgohet Komisionit European.

ç) Jep rekomandime për përmirësimin e veprimtarive, që lidhen me zbatimin e këtyre programeve, si dhe monitoron zbatimin e tyre.

d) Bashkëpunon me të gjitha strukturat për zbatimin e këtyre programeve.

dh) Verifikon shkallën e përputhshmërisë së zbatimit të programeve me legjislacionin e Bashkimit European.

e) Harton dhe i dorëzon zyrtarit përgjegjës akreditues (ZPA/CAO), zyrtarit kombëtar të autorizuar (ZKA/NAO) dhe Komisionit të BE-së:

i) Raportin vjetor të veprimtarisë audituese, sipas modelit të paraqitur në aneksin C, të marrëveshjes kuadër, i cili rendit burimet e përdorura për përgatitjen e raportit, si dhe bën një përmbledhje të pikave të dobëta, të konstatuara në sistemin menaxhues dhe kontrollues ose në tansaksione, të cilat janë evidentuar gjatë zbatimit të planit vjetor të punës për auditin, referuar 12 muajve të mëparshëm, dhe që përfundon më 30 shtator të vitit ushtrimor.

Ky raport i dorëzohet zyrtarit përgjegjës akreditues (ZPA/CAO), zyrtarit kombëtar të autorizuar (ZKA/NAO) dhe Komisionit të BE-së, deri më 31 dhjetor të çdo viti;

ii) Një vlerësim vjetor auditimi, sipas modelit të paraqitur në aneksin D të marrëveshjes kuadër, që tregon nëse sistemet menaxhuese dhe kontrolluese funksionojnë me efikasitet dhe në pajtim me kërkesat e kësaj marrëveshjeje dhe/ose të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ndërmjet

Komisionit European dhe qeverisë shqiptare. Vlerësimi vjetor i auditimit mbulon të njëjtën periudhë dhe ka të njëjtin afat me raportin vjetor të veprimtarisë audituese.

iii) Opinionin e auditimit për çdo deklaratë përfundimtare të shpenzimeve, që i dorëzohet Komisionit European nga ZKA/NAO-ja, për mbylljen e programit ose të një pjese të tij. Deklarata përfundimtare e shpenzimeve mund të përfshijë mandatpagesat e kontabilizuara, të çdo viti. Ky opinion vlerëson vlefshmërinë e aplikimit për pagesën përfundimtare dhe besueshmërinë e informacionit financiar. Opinioni i auditimit bëhet sipas modelit të paraqitur në aneksin E të marrëveshjes kuadër, dhe mund të mbështetet nga raporti përfundimtar i veprimtarisë audituese. Opinioni i dërgohet Komisionit European dhe ZPA/CAO-së në të njëjtën kohë ose të paktën brenda tre muajve pas dorëzimit nga ZKA/NAO-ja, të deklaratës përfundimtare të shpenzimeve.

ë) Përmbush kërkesa të tjera specifike për planin vjetor të punës për auditin dhe/ose raportin, vlerësimin dhe opinionin, të përmendura më lart, në përputhje me marrëveshjet sektoriale dhe ato financiare.

f) Harton metodologjinë e punës për auditimin e fondeve të akredituara nga Bashkimi European, sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit, si dhe bën vlerësimin e riskut, në veçanti, me dëshmi materiale dhe shembuj. Kjo metodologji mund të plotësohet dhe përmirësohet në bashkëpunim me Komisionin European.

5. Të drejtat dhe detyrimet në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ekzekutohen nga zyrtari përgjegjës akreditues, ZPA/CAO, pozicion i cili aktualisht mbahet nga Ministri i Financave.

6. Mënyra e organizimit të brendshëm, autoriteti, mënyra e vendimmarrjes së strukturave të agjencisë, si dhe çështje të tjera, që lidhen me veprimtarinë e kësaj agjencie, përcaktohen në rregulloren e brendshme të saj, propozuar nga drejtori i agjencisë dhe miratuar nga zyrtari përgjegjës akreditues (ZPA/CAO).

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të agjencisë rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, ndërsa pagat e tyre përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi, me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Drejtori i Agjencisë emërohet, lirohet e shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e zyrtarit përgjegjës akreditues, pozicion i cili mbahet, aktualisht, nga Ministri i Financave.

9. Drejtori i Agjencisë shkarkohet nga detyra, kur:

a) jep dorëheqjen;

b) emërohet në një detyrë tjetër;

c) humbet zotësinë juridike për të vepruar, me vendim gjykate;

ç) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjykate, të formës së prerë;

d) është i paaftë për kryerjen e detyrës.

10. Pika 11 e vendimit nr.719, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve, ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së BE-së, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA), komponenti I”, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi European, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 3.11.2009
Doli nga shtypi më 5.11.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë